



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE - DEGA E GJYKATËS PODUJEVË

Numri i lëndës: 2020:169903

Datë: 06.11.2024

Numri i dokumentit: 06407987

P.nr.458/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA NË PODUJEVË, Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni penal, gjyqtari i vetëm gjykues Besnik Sheqiri, me bashkëpunëtor profesional Launor Gërbeshi si procesmbajtës, në çështjen penale kundër të pandehurit B. S., për shkak të veprave penale: “Sulmi ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 3 lidhur me nenin 31, “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 par. 1 dhe “Kanosja” nga neni 181 par. 3 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PP.II.nr.3038/20, të datës 01.12.2020, pas përfundimit të seancës publike të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur me datë 08.10.2024, në praninë e prokurorit të shtetit Dardan Çela, të dëmtuarve P. I., B. T. dhe B. A., të pandehurit dhe mbrojtësit të tij të caktuar sipas detyrës zyrtare av. G. N., me datë 09.10.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 06.11.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri,

B. S., nga i ati H. dhe nëna H., mbiemri i vajzërisë së nënës M., i lindur më ... në fshatin S., Komuna P. ku edhe tani jeton, me numër personal të identifikimit ..., ka të kryer Fakultetin Juridik, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike-financiare, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i gjykuar më parë, gjendet në vuajtje të dënimit për veprë tjetër penale, ka qëndruar në ndalim nga data 11.07.2024, deri me datë 13.07.2024.

Ë S H T Ë F A J T O R

Sepse:

I. Me datë 11.07.2020, rreth orës 13:05, në fshatin S. – P., të pandehurit pas mosmarrëveshjeve që kishin në mes vete në lidhje me pronën, aty kanë shkuar punëtorët e gjeodezisë në shoqërim me P.-ë, për vendosjen e pikave kufizuese dhe derisa ishin në kryerjen e punës zyrtare, të pandehurit B. dhe A., fillimisht i kishin ofenduar me fjalë e më pastaj të njëjtë e kanë sulmuar punëtorin e Gjeodezisë të dëmtuarin P. I., për çka kanë intervenuar policët të cilët ishin prezent, ku edhe ka eskaluar situata dhe i dyshuari A. duke përdorur një motor për prerje të barit ka tentuar t’i godas, por nuk ka arritur, ndërsa i pandehuri B. me grusht e ka goditur të dëmtuarin – policin B. T. në fytyrë në pjesën e majtë afër syrit, për çka si pasojë e goditjes i njëjti ka marr lëndime trupore.

- me këtë ka kryer veprën penale “Sulmi ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 3, lidhur me nenin 31 të KPRK-së.

II. Në datën, kohën dhe vendin e njëjtë si në dispozitivin nën I të aktakuzës, i pandehuri me qëllim të dëmtimit të pronës së personit tjetër, me dashje duke përdorur mjet të fortë ka goditur veturën e markës A., ngjyrë e z., me targa ... , pronë e tani të dëmtuarit P. I. duke e dëmtuar të njëjtën në pjesën e pasme anësore të anës së majtë si dhe në pjesën mbrapa tek bagazhi, po ashtu i ka dëmtuar retrovizorin e anës së majtë, me ç ‘rast të dëmtuarit i ka shkaktuar dëm material.

- me këtë ka kryer veprën penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 par. 1 të KPRK-së.

III. Me datë 11.07.2020, rreth orës 15:15, i pandehuri derisa ishte duke dhënë deklaratë me shkrim në stacionin policor në P., i pandehuri B. S. ka kanosur seriozisht për jetë tani të dëmtuarin P. I., duke u shprehur me fjalët se “unë do të kërkoj kompensim nga P. pesëdhjetëmijë (50,000) euro, në të kundërtën do t’ia marr jetën”, fjalë të cilat i pandehuri i ka qitur edhe në deklaratë me shkrim, për çka tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe ankthit për jetë.

- me këtë ka kryer veprën penale “Kanosja” nga neni 181 par. 3 të KPRK-së.

Prandaj, gjykata në bazë të nenit 76 par. 1 të KPRK-së, të pandehurit:

## I P È R C A K T O N

Për veprën penale si në pikën “Sulmi ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti.

Për veprën penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 par. 1 të KPRK-së Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej dy (2) muaj.

Për veprën penale “Kanosja” nga neni 181 par. 3 të KPRK-së, Dënim me Burgim në kohëzgjatje prej gjashtë (6) muaj.

Në bazë të nenit 76 par. 2 nën-par. 2.2 dhe neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 69, 70 dhe 79 të KPRK-së, si dhe të neneve 364, 449 dhe 462 të KPP-së, të pandehurin e:

## G J Y K O N

I. ME DËNIM UNIK ME BURGIM në kohëzgjatje prej një vit (1) e katër (4) muaj, i cili dënim do të filloj së ekzekutuari në afatin prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

II. Në dënimin me burgim të pandehurit do t’i llogaritet edhe koha e kaluar në ndalim nga data 11.07.2020, deri me datë 13.07.2020.

III. DETYROHET i pandehuri që në emër të shpenzimeve të procedurës penale të paguaj: për ekspertizë mjeko ligjore shumë prej njëzet (20) Euro, për paushallin gjyqësor shumë prej

njëqind (100) Euro dhe në emër të taksës për Kompensimin e Viktimave të Krimit shumë prej njëzet (20) Euro, në afatin prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

IV. Të dëmtuarit: P. I. nga fshati G., Komuna P., B. T. me vendbanim në Rr. "P." p/n në P. dhe B. A. nga fshati S. i E., Komuna P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen në kontest të rregullt juridiko civil.

### A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm, ka ngritur aktakuzën PP.II.nr.3038/20, të datës 01.12.2020, kundër të pandehurve B. S. dhe A. S., për shkak të veprës penale në bashkëkryerje: "Sulmi ndaj personit zyrtar" nga neni 402 par. 3 lidhur me nenin 31 të KPRK-së, ndërsa i pandehuri B. S. edhe për veprat penale "Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë" nga neni 321 par. 1 dhe "Kanosja" nga neni 181 par. 3 të KPRK-së.

Lidhur me këtë çështje penale, për të pandehurin B. S. gjykata ka veçuar procedurën penale, për të njëjtin në kuptim të nenit 280 të KPP-së ka caktuar kohën për mbajtjen e shqyrtimit gjyqësor, ashtu që pas hapjes së seancës, shpalljen e çështjes për gjykim, përbërjen e gjykatës, konstatimit të prezencës së palëve, udhëzimit për të drejtat dhe detyrimet e tyre dhe pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 321 par. 1 të KPP-së, të pandehurit i ka ofruar mundësinë e deklarimit rreth fajësisë - të pranojë fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar apo të deklarojë i pafajshëm.

I pandehuri në fillim të shqyrtimit gjyqësor është deklaruar i pafajshëm për veprat penale për të cilat është akuzuar, andaj në kuptim të nenit 323 të KPP-së, shqyrtimi gjyqësor ka vazhduar me radhën e paraqitjes së provave: fjalën hyrëse të palëve, prezantimin e provave, dëgjimin e të dëmtuarve në cilësi të dëshmitarëve, mbrojtjen e të pandehurit, si dhe me fjalën përfundimtare të palëve.

Prokurori i shtetit në fjalën përfundimtare të dorëzuar me shkrim dhe të elaboruar gojarisht në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 08.10.2024, ka deklaruar se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë elementet e veprave penale për të cilat i njëjti është akuzuar dhe kjo është vërtetuar nga provat materiale dhe personale të administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor, nga të cilat nuk është kontestues fakti se i pandehuri B. me datë 11.07.2020, rreth orës 13:05, në fshatin S., Komuna P., pas një mosmarrëveshje me familjarët për çështje pronësore ku aty kishin shkuar punëtorët e gjeodezisë së bashku me polici, lidhur me vendosjen e pikave kufizuese, derisa gjeodeti P. I. ishte në detyrë, të njëjtin e ofendojnë me fjalë fyese dhe derisa ishin nisur për ta sulmuar, aty ndërhyjnë zyrtarët policor në detyrë, me ç' rast i pandehuri B. e godet në fytyrë, në pjesën e majtë afër syrit të dëmtuarin zyrtarin policor B. T., ku i njëjti pëson lëndime trupore siç konstatohet në ekspertizën mjeko ligjore me nr. të ref. ... , të datës 24.11.2020. Gjendja faktike vërtetohet edhe nga deklaratat e dëshmitarëve B. A., i cili përshkruan ngjarjen e ditës kritike, derisa të uniformuar ishin në krye të detyrës si zyrtar policor, së bashku me kolegun e tij B., kishin pranuar një informatë për një rast të dhunës në familje dhe kur ata kishin arritur në vendin e ngjarjes në fshatin S., i pandehuri B. ka tentuar të sulmojë gjeodetin, ndërsa vëllai i tij A., me një kosë bari me benzinë kishte tentuar ta godas, në atë moment i pandehuri B., duarthatë e godet kolegun e tij B. T.. Nga deklaratat e të dëmtuarit B. T. po ashtu vërtetohet se ditën kritike derisa i njëjti ishte në detyrë së bashku me kolegun e tij B. A. dhe kishin shkuar në fshatin S. për shkak të një problemi pronësor që kishte ndodhur në familjen S., të pandehurit B. dhe A. S. ishin nisur për të sulmuar gjeodetin P. I. dhe derisa kanë tentuar për ta vënë situatën nën kontroll, i pandehuri Blerim e godet me grusht në fytyrë të dëmtuarin në fjalë duke i shkaktuar lëndime

të lehta trupore, si pasojë e situatës së krijuar, ju asistojnë kolegë tjerë nga stacioni policor në P.. Nga deklarata e të dëmtuarit P. I. është vërtetuar se ditën kritike i pandehuri ishte nisur për ta sulmuar të njëjtin mirëpo që ishte penguar nga policët në detyrë, përveç kësaj i pandehuri po ashtu e kishte kanosur seriozisht të dëmtuarin në fjalë e më pas edhe i kishte dëmtuar veturën duke i shkaktuar dëm material. Nga të lartcekurat ka propozuar që të pandehurin gjykata ta shpallë fajtor dhe dënoj sipas ligjit, ndërsa me rastin e matjes së dënimit si rrethana rënduese për të pandehurin të merr parasysh shkallën e lartë të dashjes, mënyrën e kryerjes së veprës penale si dhe faktin se i njëjti është recidivist i këtyre veprave penale.

I dëmtuarit P. I. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se e mbështetë fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit duke shtuar se kërkon kompensim dëmi material për dëmin e shkaktuar si rezultat i veprimeve të pandehurit.

Të dëmtuarit B. T. dhe B. A. në fjalën përfundimtare kanë deklaruar se e mbështesin në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit, ndërsa nuk parashtruan kërkesë pasurore juridike.

Mbrojtësi i të pandehurit av. G. N. në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk është kontestues fakti se policia kanë shkuar në vendin e ngjarjes ngase sipas mbrojtjes vet i pandehuri i kishte thirrur ata dhe kjo për faktin se gjeodeti kishte shkuar në shtëpinë e tij pa ftesën e tij, ishte në arën e tij pa ftesën e tij dhe ka dëshiruar të bëjë matjet pa pëlqimin e tij, ma dje i njëjti ka dëshiruar të bindë të pandehurin B. që ky i fundit të pajtohej me caktimin e pikave kufizuese, ashtu që nga gjeodeti kishte kërkuar sqarim për veprimet e tij dhe assesi të ketë ndërmarrë ndonjë veprim për ta sulmuar mirëpo për shkak të tonit të lartë me të cilin i pandehuri i është drejtuar gjeodetit P. I., ka ndërhyrë policia dhe duke e shtyrë të pandehurin dalin nga oborri i H. S.. Sa i përket veprës penale Sulmi ndaj personit zyrtar gjatë kryerjes së detyrës zyrtare në raport me zyrtarin policor B. T., raporti mjekësor thekson vetëm një hematomë të cilën e kishte në fytyrë nënë syrin e majtë por nuk theksohet qartazi koha se nga kur kjo hematomë ishte e as nëse e njëjta ishte shkaktuar ditën kritike, lëndimet e konstatuara mund të jenë shkaktuar gjatë shtyrjes respektivisht largimit të B. S. nga oborri por jo edhe si rezultat i goditjes së qëllimshme ndaj personit zyrtar, e që në këtë rast mungon dashja si element qenësor i veprës penale. Për veprën penale Dëmtimi apo asgjësimi i pasurisë edhe pse i pandehuri shfrytëzoi të drejtën për të mos u deklaruar, pas lirimimit nga policia i është kujtuar të ketë marrë biçikletën por jo edhe të ketë goditur ndonjë mjet me të, ndërsa për veprën penale Kanosja, se në polici kishte deklaruar se do i kërkonte pesëdhjetëmijë (50,000) euro ose do t'ia marr jetën, këtë e kishte thënë në nervozizëm e sipër për tërë situatën e krijuar mirëpo jo edhe të ketë menduar apo të ketë ndërmarr ndonjë veprim në këtë drejtim. Mbrojtja më tej thekson se ditën kur ngjarja ka ndodhur, i pandehuri nuk ka pasur ndonjë motiv për të kryer veprat penale që i vihen në barrë, andaj në bazuar në nenin 3 par. 2, i cili për cakton se “Mëdyshjet lidhur me ekzistimin e fakteve të rëndësishme për çështjen ose për zbatimin e ndonjë dispozite të ligjit penal interpretohen në favor të të pandehurit dhe të drejtave të tij sipas këtij Kodi dhe sipas Kushtetutës së Republikës së Kosovës”. Nga sa u tha më lartë, në mungesë të provave të artikuleshme për të mbështetur një dyshim të bazuar mirë se i pandehuri ka kryer veprat penale të cilat i vihen në barrë, gjykatës i propozon që me rastin e nxjerrjes së vendimit lidhur me përgjegjësinë e të pandehurit, të ketë parasysh të gjitha rrethanat dhe në vështrim të nenit 363 par. 1 nën-par. 1.3 të KPP-së të nxjerr aktgjykim me të cilin të pandehurin e liron nga përgjegjësia, sepse nuk është provuar se i njëjti ka kryer veprat penale për të cilat akuzohet.

I pandehuri B. S. nuk është deklaruar dhe ka refuzuar të paraqes fjalën përfundimtare.

Gjykata për vërtetimin e gjendjes faktike në këtë çështje penale, në kuptim të dispozitave ligjore të nenit 7 dhe nenit 360 të KPP-së, ka bërë administrimin e provave të propozuara nga prokurori i shtetit si në aktakuzë: janë lexuar Raporti i policisë nga vendi i ngjarjes, deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve B. T., B. A. dhe P. I. të dhëna në polici, Ekspertiza mjeko ligjore për të dëmtuarin B. T., foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, vendimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendit i datës 11.07.2020, në cilësi të dëshmitarëve janë dëgjuar B. T., B. A. dhe P. I., ndërsa i pandehuri ka paraqitur mbrojtjen e tij.

I dëmtuari – dëshmitari B. T., gjatë marrjes në pyetje në polici me datë 11.07.2020 ngjashëm sikurse edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 07.08.2024, ka deklaruar se ditën kritike të datës 11.07.2020, me të arritur në vendin e ngjarjes në fshatin S. të P., kanë takuar ankuesin tani të pandehurin B. S., të cilin për shkak të një kontesti pronësor që kishte më vëllain e tij H. S., e kanë udhëzuar që t'i drejtohet gjykatës për zgjidhjen e kontestit pronësor, ndërsa derisa pas kësaj kishin shkuar në oborrin e shtëpisë së H. S. ku aty prezent ishte edhe gjeodeti P. I., befas kanë shkuar të pandehurit B. dhe A. S. të cilët kanë ftuar gjeodetin që të diskutojnë lidhur me paluajtshmërinë në fjalë, dhe posa gjeodeti u është afruar atyre, i pandehuri B. i është vërsulur të njëjtit duke tentuar ta sulmojë duarthatë, sulm të cilin kanë arritur ta evitojnë. Në cilësi të personave zyrtar për shkak të mos përfilljes së urdhrave zyrtar nga i pandehuri B. S., derisa kanë tentuar ta arrestojnë të njëjtin, vëllai i tij A. S. me një prerëse bari ka dashur ta godas kolegun e tij tani të dëmtuarin B. A. dhe duke e parë rrezikun që i kanosej kolegut të tij, lëshon të pandehurin B. për ta tërhequr mbrapa kolegun e tij me qëllim të shmangies nga goditja, moment të cilin i pandehuri B. S. e shfrytëzon dhe papritmas e godet me grusht në fytyrë afër syrit të majtë, ndërsa po ashtu derisa të pandehurit ishin në rrugë duke u larguar, i pandehuri B. S. e godet me një biçikletë veturën e të dëmtuarit P. I. duke i shkaktuar dëm material.

I dëmtuari – dëshmitari B. A., gjatë marrjes në pyetje në polici ka deklaruar se me datë 11.07.2020 sikurse edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 07.08.2024, ka deklaruar se ditën kritike, rreth orës 13:00, nga baza janë informuar për një rast kontest pronësor në fshatin S. dhe me të arritur në vendin e ngjarjes janë takuar me ankuesin tani të pandehurin B. S. i cili është ankuar se vëllai i tij H. S. pa e njoftuar paraprakisht, ka ftuar gjeodetin për ndarjen e parcelave të ngastrës e cila është në emër të gjyshes së tij Gj. S. tani pronë e përbashkët mes dy vëllezërve B. dhe H. S.. E tërë ngjarja kishte filluar derisa ishin në oborrin e shtëpisë së H. S. ku aty prezent ishte edhe gjeodeti P. I., befas kanë shkuar të pandehurit B. dhe A. S. të cilët kanë ftuar gjeodetin që të diskutojnë lidhur me paluajtshmërinë në fjalë, dhe posa gjeodeti u është afruar atyre, i pandehuri B. i është vërsulur të njëjtit duke tentuar ta sulmojë duarthatë, sulm të cilin në cilësi të personave zyrtar e kanë evituar. Për shkak të mospërfilljes së urdhrave zyrtar, ka qenë domosdo i nevojshëm përdorimi i forcës duarthatë për ta vënë nën kontroll të njëjtin, ndërsa vëllai i tij A., me një kosë prerëse bari, derisa dëshmitari në fjalë së bashku me kolegun e tij tani të dëmtuarin B. T. e mbanin të pandehurin B., i pandehuri A. ka ngritur lartë kosën e dorës duke tentuar ta godas atë, mirëpo në momentin kritik kolegu i tij B. T. e ka tërhequr duke e shmangur nga goditja, ndërsa të njëjtën kohë e godet me grusht në fytyrë kolegun e tij B., përveç kësaj, i pandehuri B. me një biçikletë si dhe me prerësen e barit e godet dhe e dëmton veturën A. ... pronë e gjeodetit, duke i shkaktuar dëm material.

I dëmtuari – dëshmitari P. I., gjatë marrjes në pyetje në polici me datë 11.07.2020 ngjashëm sikurse edhe në seancën e shqyrtimit gjyqësor të datës 23.09.2024, ka deklaruar se derisa në cilësi të gjeodetit të licencuar kishte shkuar tek shtëpia e të pandehurit B. S. për ta njoftuar lidhur me kërkesën e parashtruar ditë më parë gjegjësisht me datë 10.07.2020 nga vëllai i tij H. S. për dalje në vendin e ngjarjes, i pandehuri nuk është pajtuar për matjen e ngastrës kadastrale e evidentuar në emër të Gj. S., me nr. ... , Zona Kadastrale në fshatin S. të P., ashtu që kishte

shkuar përsëri tek parashtruesi i kërkesës për ta njoftuar të njëjtin për pamundësinë e përfundimit të procedurës për shkak të mos arritjes së pajtueshmërisë mes palëve. Derisa kishte qenë tek H. S., në vendin e ngjarjes kanë arritur policia, më pas tek dyert e oborrit të H. S. shkon vëllai i tij tani i pandehuri B. i cili të dëmtuarit i është drejtuar me një ton të lartë dhe e fton që t'i afrohet dhe posa ky i afrohet atij, i pandehuri i drejtohet me fjalët “a ke qitë pika”, çka tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e frikës dhe pasigurisë. Derisa zyrtarët policor i afrohen të pandehurit për të vënë situatën nën kontroll, i dëmtuari largohet dhe futet në oborrin e H. S., ndërsa dëgjon zhurma mes policëve dhe palëve, sikurse edhe dëgjon goditje të automjetit të tij, mirëpo nuk e kishte parë se kush i kishte dëmtuar automjetin ngase aty prapa murit kishte qëndruar derisa policia e kanë udhëzuar për të shkuar në stacion policor.

Pas marrjes në pyetje të dëmtuarve – dëshmitarëve, si dhe prezantimit të provave materiale, në kuptim të nenit 343 par. 1 të KPP-së është ftuar i pandehuri që të merret në pyetje për të paraqitur versionin e tij lidhur me ngjarjen, mirëpo i njëjti i njoftuar më parë për të drejtën për të heshtur dhe mos u deklaruar, e drejtë kjo e paraparë me dispozitat ligjore të nenit 344 par. 1, lidhur me nenin 122 par. 3 dhe 150 par. 3 nën-par. 3.3 të KPP-së, ka shfrytëzuar këtë të drejtë dhe ka deklaruar se nuk dëshiron të dëshmojë.

Rrjedhimisht gjykata, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave dhe vlerësimit me ndërgjegje të secilës provë një nga një dhe në lidhje reciproke me njëra tjetrën, konform nenit 360 par.1 dhe 2 të KPP-së, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

I pandehuri në shqyrtim gjyqësor ka shfrytëzuar të drejtën për të mos u deklaruar lidhur me çështjen, mirëpo gjatë marrjes në pyetje në polici i njëjti nuk e kishte kontestuar faktin se ditën kritike me biçikletën e tij e kishte dëmtuar automjetin e tani të dëmtuarit P. I. duke e goditur retrovizorin dhe pjesë tjera të automjetit, veprim të cilin e kishte bërë ngase sipas tij njëri nga zyrtarët policor kishte nxjerrë sprejin ndërsa tjetri armën zyrtare të cilën ia kishte drejtuar atij, po ashtu nuk ishte kontestuese të ketë deklaruar se “..unë do të kërkojë kompensim nga P. në vlerë prej 50 mijë euro, në të kundërtën do të ja marr jetën”.

Kontestues nga i pandehuri ishte fakti se gjatë marrjes në pyetje në polici i njëjti kishte mohuar të ketë ndërmarrë ndonjë veprim konkret inkriminues në drejtim të veprës penale si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi ngase sipas tij nuk kishte pasur asnjë kontakt fizik me ndonjërin nga zyrtarët policor.

I pandehuri është shpallur fajtor për veprat penale të kryera në bashkim real dhe atë: “Sulmi ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 3 lidhur me par. 1, “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 par. 1 dhe “Kanosja” nga neni 181 par. 3 të KPRK-së.

Në sensin e inkriminimit forma themelore e veprës penale “Sulmi ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së ekziston kur kryesi i veprës e sulmon apo kanoset seriozisht se do të sulmojë personin zyrtar, ndërsa forma e kualifikuar e kësaj vepre penale është paraparë në paragrafin 3 të të njëjtit nen në të cilën është përcaktuar se “Nëse vepra penale nga paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo ndihmësit të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm...”

Nga deklaratat e të dëmtuarit - dëshmitarit B. T. është vërtetuar fakti se ditën kritike, derisa së bashku me kolegun e tij tani të dëmtuarin B. A. ishin në krye të detyrës zyrtare, në vendin e ngjarjes respektivisht në afërsi të shtëpisë së H. S. në fshatin S., i pandehuri B. S. tenton të sulmojë të dëmtuarin P. I., dëshmitari në fjalë së bashku me kolegun e tij reagojnë dhe arrijnë që këtë sulm ta evitojnë, mirëpo në momentin kritik derisa i dëmtuari tërheqë kolegun e tij B.

A. për ta shmangur nga goditja me prerëse bari nga i pandehuri A. S., i pandehuri B. në befasi e godet me grusht në fytyrë në regjionin e syrit të majtë, duke i shkaktuar lëndime të lehta trupore.

Nga deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit B. A. është vërtetuar fakti se ditën kritike, derisa së bashku me kolegun e tij tani të dëmtuarin B. T. ishin në krye të detyrës zyrtare dhe derisa i pandehuri A. S. vëllai i të pandehurit B. S. ka tentuar ta godas të dëmtuarin me prerëse bari (kosë), kolegu i tij tani i dëmtuari B. T. e tëherë atë për ta shmangur nga goditja, ndërsa të njëjtën kohë i pandehuri B. e godet me grusht në fytyrë kolegun e tij B. T..

Nga deklarata e të dëmtuarit – dëshmitarit P. I. është vërtetuar fakti se ditën kritike derisa kishte qenë në oborrin e shtëpisë së H. S., aty shkon i pandehuri B. S. i cili e thërret të dëmtuarin me një ton të lartë ashtu që nxitë reagimin e zyrtarëve policor të cilët për ta vënë situatën nën kontroll reagojnë dhe i afrohen atij, ndërsa i dëmtuari me qëllim të shmangies së konfrontimit me të pandehurin, me shpejtësi largohet dhe futet në oborrin e H. S., ku nga aty vetëm dëgjon zhurma në mes të zyrtarëve policor dhe palëve.

Nga mendimi i ekspertit mjeko ligjor të përshkruara si në Akt – ekspertimin mjeko ligjor për të dëmtuarin B. T., me nr. Reference ..., i datës 24.11.2020, punuar nga eksperti mjeko ligjor Dr. V. K., rezulton se pas analizës profesionale mjeko ligjore të shkresave të lëndës, dëmtimet e përshkruara paraqesin ndrydhje (mbretje) të indeve të buta me gjak mbledhje nën lëkurore të regjionit të mollëzës së majtë të fytyrës dhe gjak mbledhje nën lëkurore të syrit të majtë, me besueshmëri të shkaktuara nga veprimi mekanik i mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur), ku si të tilla bëjnë pjesë në dëmtime të lehta trupore me pasoja të përkohshme për shëndetin.

Nga foto dokumentacioni i cili gjendet në shkresat e lëndës lidhur me ngjarjen e ditës kritike të datës 11.07.2020 dhe atë: në fotot nr. 62 dhe 63, shihet qartë një hematomë në regjionin e syrit të majtë të të dëmtuarit B. T. – zyrtar policor, fotot nr. 65 dhe 66 shihen dëmet e shkaktuara në automjetin A. ngjyrë e k. metalike, me targa të regjistrimit ..., dhe atë dëmtime në pjesën e prapme të bagazhit të automjetit si dhe retrovizori i thyer i anës së djathtë, në foto nr. ... shihet një (1) prerëse bari (kosë) dore, foto nr. ... shihet kopja e polisës së sigurimit me nr. ..., për automjetin A... ... (...), me nr. ..., ndërsa në foto nr. ... shihet kopja e librezës së është tani i dëmtuari P. I..

Deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve B. T., B. A. dhe P. I. marr parasysh dallimet kohore nga marrja e tyre në pyetje në polici, të njëjtit në shqyrtim gjyqësor janë marr në pyetje në mënyrë të hollësishme për të kontrolluar besueshmërinë e deklarimeve të tyre, gjithashtu për të parë nëse të njëjtit kishin ndonjë motiv të mundshëm kundër të pandehurit, mirëpo gjykata ka ardhur në përfundim se deklaratimet e tyre janë tërësisht të besueshme, reale dhe objektive, jo të motivuar personalisht, përveç kësaj deklarimet e tyre janë në përputhshmëri edhe me provat tjera të administruara në shqyrtim gjyqësor, Akt-ekspertimin mjeko-ligjor të datës 24.11.2020 të ekspertit mjeko - ligjor Dr. V. K., si dhe gjendjen faktike të vërtetuar.

Gjykata ka vërtetuar faktet lidhur me ekzistimin e veprës penale “Sulmi ndaj personit zyrtar” nga neni 402 par. 3 lidhur me par. 1 të KPRK-së, ngase veprimi i kryerjes së kësaj vepre penale ekziston kur kryesi i veprës e sulmon apo kanoset seriozisht se do të sulmojë personin zyrtar, fakte të cilat janë vërtetuar nga provat materiale që gjenden në shkresat e lëndës dhe atë deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve B. T., B. A. dhe P. I., ndërsa formën e kualifikuar të kësaj vepre penale e përcakton pasoja e shkaktuar si rezultat i veprimeve të shkaktuara nga ana e kryesit të veprës penale, ashtu që në paragrafin 3 është përcaktuar se “Nëse vepra penale nga

*paragrafi 1. i këtij neni rezulton me lëndim të lehtë trupor të personit zyrtar apo ndihmësit të tij ose përfshin kanosje për përdorimin e armës apo mjetit të rrezikshëm...”, rrethanë kjo e vërtetuar nga Akt – ekspertimi mjeko ligjor për të dëmtuarin B. T., me nr. Reference ... , i datës 24.11.2020, i cili sqaron se deri tek lëndimi i lehtë trupor i të dëmtuarit B. T., ka ardhur si pasojë e veprimit mekanik të mjetit të fortë mbretës (jo i mprehtë, i topitur), e cila ekspertizë është në përputhje të plotë edhe me deklaratat e dëshmitarëve të lartcekur, foto albumin i cili gjendet në shkresat e lëndës, si dhe gjendjen faktike të vërtetuar.*

Gjykata po ashtu ka vërtetuar faktet lidhur me ekzistimin e veprës penale “Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë” nga neni 321 par. 1 të KPRK-së të përshkruara si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 3 të KPRK-së si në pikën III të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Bazuar në deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve B. T. dhe B. A. – zyrtar policor, të cilët ditën kritike derisa ishin në kryerje të detyrës zyrtare, duke bërë përpjekje për të arrestuar të pandehurin i cili përpos mosbindjes ndaj urdhrave zyrtar dhe sulmit fizik ndaj zyrtarit policor B. T., në përpjekje për të ikur apo shmangur arrestimit të tij nga zyrtarët policor, me biçikletën e tij e godet dhe e dëmton automjetin e të dëmtuarit P. I., fakt i cili vërtetohet edhe nga foto albumi i cili gjendet në shkresat e lëndës ku shihet automjeti i dëmtuar, si dhe deklarimi i vet të pandehurit, i cili gjatë marrjes në pyetje në polici nuk e kishte kontestuar faktin se ditën kritike me biçikletën e tij e kishte dëmtuar automjetin e tani të dëmtuarit P. I. duke e goditur dhe dëmtuar retrovizorin dhe pjesë tjera të automjetit.

Sa i përket vërtetimit të fakteve lidhur me ekzistimin e veprës penale “Kanosja” nga neni 181 par. 3 të KPRK-së, në paragrafin 1 të të njëjtit nen është përcaktuar se “Kushdo që seriozisht e kanos personin tjetër me fjalë, vepra apo gjeste se do t’i shkaktoj ndonjë të keqe me qëllim të frikësimit ose të shkaktimit të ankthit te personi i tillë...”, e që nga deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve të lartcekur si dhe rrethanat e rastit konkret, rezulton fakti se i pandehuri i vetëdijshëm për veprimet të cilat i kishte ndërmarrë ditën kritike në kuadër të dashjes së tij, pas shoqërimit të tij në stacion policor, e kanos seriozisht personin zyrtar këtu të dëmtuarin P. I. - gjeodet me fjalët “...kërkoj kompensim nga P. në vlerë prej 50 mijë euro, në të kundërtën do të ia marr jetën”, deklarim i cili tek i dëmtuari ka shkaktuar ndjenjën e ankthit, frikës dhe pasigurisë për jetë, përveç kësaj, ditën kritike i pandehuri me veprime konkludente, gjeste, ka kanosur të dëmtuarin duke tentuar edhe ta sulmojë gjë që kishte provokuar arrestimin e tij nga ana e policisë.

Gjykata po ashtu me kujdes të posaçëm analizoi dhe vlerësoi pretendimet e mbrojtësit të pandehurit av. G. N., e cila konsiston në atë se i mbrojturi i tij nuk ka ndërmarr ndonjë veprim konkret inkriminues në drejtim të veprave penale për të cilat është akuzuar ngase sipas mbrojtjes edhe pse në raportin mjekësor për të dëmtuarin B. T. është konstatuar vetëm një hematoma në fytyrë nën syrin e majtë, mirëpo nuk është theksuar qartazi koha kur është shkaktuar dhe se lëndimet e pësuar tek i dëmtuari mund të jenë shkaktuar gjatë largimit të pandehurit nga oborri por jo edhe si rezultat i goditjes së qëllimshme të personit zyrtar nga ana e tij. Sa i përket veprës penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë, mbrojtja më tej thekson se të pandehurit i është kujtuar të ketë marr biçikletën e tij por jo edhe ta ketë goditur ndonjë mjet me të, ndërsa për veprën penale Kanosja, edhe pse i pandehuri në polici ka deklaruar se do t’i kërkojë 50 mijë euro të dëmtuarit P. I. në të kundërtën do të ia marr jetën, këtë e ka thënë duke qenë i nervozuar për situatën e krijuar por jo edhe të ketë menduar të ndërmarr ndonjë veprim në këtë drejtim, pretendime këto të cilat gjykata i çmoi si të pa bazuara dhe të pa mbështetura



në prova konkrete, në të kundërtën e kësaj, të njëjtat janë në kundërshtim me provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, gjendjen faktike si dhe me rrjedhën logjike të ngjarjes.

Gjykata pas vlerësimit të rrethanave të rëndësishme, bazuar në faktet dhe provat e administruara në shqyrtim gjyqësor, deklaratat e të dëmtuarve – dëshmitarëve B. T., B. A. dhe P. I., Ekspertizat mjeko ligjore për të dëmtuarin B. T., foto dokumentacioni i vendit të ngjarjes, pjesërisht mbrojtjes së të pandehurit, vërtetoi gjendjen faktike si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, nxjerri konkluzion të drejtë dhe të ligjshëm dhe gjeti se në veprimet e të pandehurit të ndërmarra në kuadër të dashjes së tij, në kohë, vend dhe mënyrë të përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, në bashkim real ka kryer veprat penale për të cilat është akuzuar, andaj pasi që më parë gjeti se i njëjti në aspektin penal-juridik është përgjegjës dhe nuk ekzistojnë rrethana të cilat përjashtojnë përgjegjësinë e tij penale, të njëjtin e shpalli fajtor dhe me aplikimin e dispozitës ligjore të nenit 76 par. 2 nën-par. 2.2 të KPP-së, të njëjtin e shpalli fajtor dhe i shqiptoi dënimin unik me burgim si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Me rastin e vendosjes së llojit dhe lartësisë së dënimit, gjykata mori parasysh të gjitha rrethanat e mundshme lehtësuese dhe ato rënduese të parapara me nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, të cilat janë me ndikim me rastin e marrjes së vendimit, ashtu që në rastin konkret rrethana lehtësuese për të pandehurin nuk gjeti, ndërsa sa i përket rrethanave rënduese në raport me veprat penale të kryera nga i pandehuri, gjykata mori parasysh shkallën e lartë të dashjes së të pandehurit në kryerjen e veprave penale e manifestuar përmes veprimeve proaktive të tij, edhe pse i njëjti në cilësi të palës ankuese lidhur me një kontest pronësor që kishte me vëllain e tij kishte lajmëruar policinë, nuk u bindet urdhrave zyrtar të tyre dhe përveç faktit të provuar se i njëjtit tenton të sulmojë të dëmtuarin P. I., i njëjti po ashtu sulmon zyrtarin policor të uniformuar tani të dëmtuarin B. T., rrethana tjera rënduese gjykata po ashtu mori parasysh prezencën e dhunës në kryerjen e veprave penale, vepra penale përfshinë disa viktime - të dëmtuar në të njëjtën ngjarje e që në kontekst të kësaj rritë edhe përgjegjësinë penale të tij, duke e bërë të domosdoshëm shqiptimin e një sanksioni më të rëndë penal, të cilat gjykata do t'i reflektojë në caktimin e masës së dënimit. Nga Qendra e evidencës penale për të dënuarit e cila shpërfaqë personalitetin e të pandehurit, rezulton fakti se i njëjti më parë ka qenë i gjykuar edhe për vepra tjera penale dhe atë: sipas aktgjykimit P.nr.12/2019, data e plotfuqishmërisë 20.01.202, për veprën penale Pengimi i personit zyrtar nga neni 409 par. 1 dhe 4 të KPRK-së, i dënuar me dënim me kusht, P.nr.328/19, data e plotfuqishmërisë 26.02.2021, për veprën penale Lëndimi i lehtë trupor nga neni 185 par. 1 nën-par. 1.4 dhe par. 3 nën-par. 3.1 të KPRK-së, P.nr.65/21, data e plotfuqishmërisë 03.05.2021, për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, P.nr.9/21, data e plotfuqishmërisë 28.06.2021, për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, P.nr.353/21, data e plotfuqishmërisë 11.10.2021, për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej njëqind e pesëdhjetë (150) euro, P.nr.331/20, data e plotfuqishmërisë 05.01.2020, për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej katërqind (400) euro, P.nr.83/22, data e plotfuqishmërisë 04.07.2022, për veprën penale Sulmi nga neni 184 par. 1, 367 par. 1, 321 par. 1 dhe 185 par. 2 të KPRK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) viti e gjashtë (6) muaj, P.nr.181/19, data e plotfuqishmërisë 20.09.2022, për veprën penale Zjarrvënia nga neni 334 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, P.nr.283/20, data e plotfuqishmërisë 21.12.2022, për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 të KPRK-së, i është shqiptuar vërejtje gjyqësore, P.nr.150/20, data e plotfuqishmërisë 26.01.2023, për veprën penale Sulmi nga neni 184 par. 1 dhe par. 3, nën-par. 3.1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me kusht, P.nr.163/23, data e

plotfuqishmërisë 05.06.2023, për veprën penale Mbjajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 366 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, P.nr.49/23, data e plotfuqishmërisë 28.07.2023, për veprën penale Kanosja nga neni 181 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej treqind (300) euro, P.nr.360/22, data e plotfuqishmërisë 19.09.2023, për veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 409 par. 1 dhe 2 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej dymijë (2,000) euro, P.nr.452/20, data e plotfuqishmërisë 19.12.2023, për veprën penale Asgjësimi apo dëmtimi i pasurisë nga neni 321 par. 1 dhe neni 410 par. 1 të KPRK-së, i dënuar me dënim me burgim në kohëzgjatje prej tetë (8) muaj dhe P.nr.82/21, data e plotfuqishmërisë 21.03.2024, për veprën penale Vetëgjyqësia nga neni 410 par. 2 dhe veprës penale Kanosja nga neni 181 par. 3 të KPRK-së, i dënuar me dënim me gjobë në shumë prej dymijë e pesëqind (2,500) euro dhe dënim me burgim në kohëzgjatje prej një (1) muaj e njëzet e tre (23) ditë, andaj ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të pandehurit është adekuat dhe në përputhshmëri me peshën e veprave penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, me bindje se një dënim i tillë do të arrihet qëllimi i dënimit i paraparë me nenin 38 të KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen, të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat tjerë në kryerjen e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Vendimi mbi llogaritjen e kohës së kaluar në ndalim në dënimin me burgim është marrë në bazë të nenit 79 të KPRK-së.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale dhe paushallit gjyqësor është marrë në bazë të nenit 449 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 lidhur me nenin 452 par. 1 të KPP-së, ndërsa vendimi për kompensimin e viktimave të krimit është marrë konform nenit 36 par. 3 nën-par. 3.1 të Ligjit nr. 08/L-109 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Vendimi mbi udhëzimin e të dëmtuarve për realizimin e kërkesës pasurore juridike në kontest të rregullt juridiko civil është marrë në bazë të nenit 462 par. 2 të KPP-së.

Nga sa u tha më lartë e në bazë të nenit 364 të KPP-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË - DEGA PODUJEVË  
Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Penal  
P.nr.458/22, Datë 06.11.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues  
Besnik Sheqiri

---

Numri i lëndës: 2020:169903  
Datë: 06.11.2024  
Numri i dokumentit: 06407987

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi palët mund të ushtrojnë ankesë në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë nëpërmjet kësaj Gjykate.